

**AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“REAL CALL”**

Sot në Tiranë, më 11.04.2024, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “**REAL CALL**”.

Unë ortaku i vetëm Ardit Malushi, i datëlindjes 07.12.1990, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin me numër personal J01207061K madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare “REAL CALL”, e cila do ti nënshtronhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare “REAL CALL” do të jetë në adresën: **Rruga Qemal Stafa, Pallati nr 66, Shkalla 1, Ap.Nr.1, TIRANË**.

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar me objekt: **Zhvillimi i aktivitetit të Call Center ndërkombëtar, si për aktivitete inbound ashtu dhe për aktivitete outbound, në shërbim të klientëve me rezidencë në Shqipëri dhe jashtë saj.**

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (Njëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7



Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "REAL CALL" do të drejtohet nga Administratori i saj Z.Ardit Malushi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjeter, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "REAL CALL" do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "REAL CALL" deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjisacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar si më poshtë:

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"REAL CALL"

ORTAKU I VETËM

Ardit Malushi

Ardit Malushi
AM